webercol gress G

C2T Ngjitës gri për pllaka jo poroze gres/porcelan

Përshkrimi

webercol gress është një ngjitës i parapregatitur me bazë çimento gri, inertesh të përzgjedhura dhe aditivësh specifikë që përmirësojnë ngjitjen dhe punueshmërinë. Klasifikimi C2T.

Avantazhet

- për pllaka gresi të dimesioneve të mesme deri ne 60x60cm
- për pllaka gresi dhe porcelani
- përdorim në sipërfaqe vertikale dhe horizontale

Përdorimi

- **webercol gress G** përdoret për ngjitjen e pllakave poroze dhe jo poroze të dimensioneve të mesme në mjedise të brendshme, në sipërfaqe vertikale dhe horizontale.
- Produkti mund te perdoret ne siperfaqe te jashtme te hidroizoluara dhe jo ne kontakt direkt me kushtet e motit.
- Nuk keshillohet te perdoret ne zona me kushte ekstreme te motit, ngrice ose termperatura shume te larta.

Përgatitja e bazamentit

- Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C ,
- Bazamentet duhet të jenë të fortë, të thatë, të pastër dhe të niveluar. Në rastet e suporteve të vjetra, apo dhe llaçit tradicional, këshillohet që bazamenti të paratrajtohet me astarin e përshtatshëm.
- Bazamentet e betonit, llustrat e çimentos dhe llaçet me bazë çimento dhe gëlqere duhet të jenë min. 28 ditë me lagështi të mbetur ≤ 1,5%.
- Bazamentet prej gëlqereje dhe çimento duhet të trajtohen me astarin weberprim deep, ndërsa sipërfaqet e betonit duhet të trajtohen me weberprim 813. Astaret duhet të aplikohen sipas udhëzimeve në fletët teknike të produktit.

Udhëzime mbi aplikimin

- Përzierja e produktit me ujë bëhet në një enë të pastër. Përmbajtja e thesit prej 25kg shtohet ngadalë në 6.5-7 litra ujë dhe përzjehet me anë të përzjerësit elektrik me xhiro të ulëta ose mistri, derisa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza.
- Përzierja e përgatitur duhet të pushojë për 5 minuta para se të proçedohet me fazën e aplikimit.
- Masa e përgatitur ripërzihet me anë të një mistrie dhe aplikohet në bazament me një spatul me dhëmbë, në bazë të madhësisë dhe llojit të pllakës.
- Hapet fillimisht një shtresë e hollë materiali me anën e drejtë të spatulës, jo vetëm për të eleminuar kështu ndonjë mbetje pluhuri, por gjithashtu për të rregulluar përthithjen e nënshtresës, në mënyrë që të shfrytëzohet më së miri koha e caktuar e hapjes.
- Me pas kalohet malla e dhembezuar me dimensione max 10x10mm.
- Pllakat aplikohen duke bërë një lëvizje të lehtë nën presion dhe duke i goditur me kujdes në mënyrë që komplet sipërfaqja të jetë në kontakt me kollën.
- Lëvizjet e nevojshme të pllakave kryhen brenda 20 min nga aplikimi i ngjitesit. Në raste të formimit të filmit në sipërfaqen e kollës këshillohet të kalohet një shtresë e njomë ngjitësi me spatulën e dhëmbëzuar. Nëse pllaka nuk është ngjitur brenda intervalit të caktuar, hiqni ngjitësin dhe zëvendësojeni me ngjitës të freskët.
- Periudha kohore nga vendosja e ngjitësit në sipërfaqe dhe pllakë deri në vendosjen e pllakës nuk duhet të kalojë 20 minuta në kushte optimale të motit.
- Materiali i përzier duhet të përdoret brenda 120 minutave. Mos i vendosni ngarkesë mbi pllaka për të paktën 24 orë

**Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.*

SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA sh.p.k
Rr. Budull, Nr.3 • 1039 Ahmetaq
Sales.Department@saint-gobain.com,
www.saint-gobain.al
+355 69 20 24 002

webercol evoflex G

C2T Ngjitës gri për pllaka jo poroze gres/porcelan

- pas shtrimit, në mënyrë që të arrihet ngjitje e mirë.
- Është e këshillueshme që bojaku të aplikohet pas 24-48 orësh.

Siguria e produktit

- Përbërësit e rrezikshëm të përbërjes: çimento Portland

- Mund të çojë në dëmtime të rënda të syrit. Shkakton acarim të lëkurës. Mund të shkaktojë reaksione alergjike të lëkurës. Mund të shkaktojë acarim të organeve të frymëmarrjes. Vishni doreza mbrojtëse, rroba mbrojtëse, syze mbrojtëse dhe mbrojtje për fytyrën. NË RAST KONTAKTI ME SYTË: Shpëlajeni me kujdes me ujë për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit, nëse ka, dhe nëse është e mundur. Vazhdoni të shpëlani.
  Telefononi menjëherë QENDRËN E KONTROLLIT TË HELMIMIT ose kontaktoni një mjek. NË RAST KONTAKTI ME LËKURËN: Shpëlajeni me ujë të bollshëm dhe sapun. NË RAST THYMËRI: Çojeni personin në ajër të pastër dhe vendoseni në një pozicion që lehtëson frymëmarrjen.
- Përmbajtja e kromit të tretshëm Cr (VI) në produkt është më pak se 0.0002% e llogaritur në masën totale të çimentos së thatë

Veglat

Përgatitja: mikser elektrik, enë për përzierje.
Aplikimi: mallë çeliku të dhëmbëzuar

Jetëgjatësia

12 muaj, i magazinuar mbi paletë në zona të thata dhe pa ndikim të drejtpërdrejtë nga kushtet e motit. Duhet mbrojtur nga ngrica.

Asgjësimi

Produkti i papërdorur dhe paketimi bosh nuk mund të hidhen jashtë hapësirave të menaxhimit të mbetjeve. Shikoni fletën e të dhënave të sigurisë së produktit dhe kërkesat legjislative për më shumë informacion.

**Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.*

SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA sh.p.k
Rr. Budull, Nr.3 • 1039 Ahmetaq
Sales.Department@saint-gobain.com,
www.saint-gobain.al
+355 69 20 24 002

webercol gress G

C2T Ngjitës gri për pllaka jo poroze gres/porcelan

Tabela e te dhenave teknike

Lloji i paketimit	thes letre	
Sasi per njesi	25 kg / paketim 1350 kg / palete	54 thase / palete
Ngjyra	gri	
Kokerrzimi	0.7 mm	
Konsumi	3-5 kg	Te dhenat mbi konsumin jane orientuese dhe ne varesi te karakteristikave te bazamentit dhe teknikes se aplikimit.
Konsumi i ujit	6,5-7 l	
Trashesia e shtreses	10 mm	

Tabela e performances

PARAMETRAT	VLERA MESATARE	NJESIA MATESE
Rezistenca në përkulje	NA	
Rezistenca në tërheqje 28 ditore	≥ 1	Mpa
Rezistenca në tërheqje pas cikleve ngrirje-shkrirje	≥ 1	Mpa
Rezistenca në tërheqje pas nxehtësisë	≥ 1	Mpa
Rezistenca në tërheqje pas zhytjes në ujë	≥ 1	Mpa

**Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.*

SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA sh.p.k
Rr. Budull, Nr.3 • 1039 Ahmetaq
Sales.Department@saint-gobain.com,
www.saint-gobain.al
+355 69 20 24 002